



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA EKONOMISË, KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 158 .Prot

Elbasan më 22.02.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarivë të ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”,ne Urdherin nr.966/1.prot nr. 49, date 12.02.2024 ,“ Per miratimin e numrit te Instruktove dhe Mesuesve me kohe te pjesshme per vitin 2024”

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet :

- Instruktor/e Estetike - **1 person**
- Instruktor/e Instalime dhe Mirembajtje rrjeti Elektrik, Instalime te paneleve diellore fotovoltaike - **3 persona**
- Instruktor/e Instalime dhe Mirembajtje rrjeti Hidraulik, Mirembajtje paneleve diellore -**2 persona**
- Instruktor/e Kuzhine , Kasap , Perpunim mishi, Sherbime ne Bujtina , Sherbim Bar Restoranti, - **5 persona**
- Instruktor/e Mobileri - **1 person**
- Instruktor/e Parukeri - **4 persona**

- Instruktor/e Punime Muratimi Suvatimi, Punime Pllakashtrimi, Hekurkthim , Bojatisje, Punime ndertimi, Karpentieri - **1 person**
- Instruktor/e Elektroshtepiake - **1 person**
- Instruktor/e Rrobaqepsi , Rrobaqepsi per Fasoneri - **2 persona**
- Instruktor/e Saldim, Punime Duralumini - **1 person**
- Instruktor/e Servis Elektroauto ne automjetet e lehta- **1 person**
- Instruktor/e Servis Motori ne Automjetet e lehta , Automekanik , Lllamarinist , Bojatisje Automjetesh - **1 person**
- Instruktor/e Frutikulture , Kopshtari - **1 person**
- Instruktor/e Sherbim Mikpritje Hotelererie , Udherrefim Turistik - **1 person**
- Instruktor/e Instalim dhe Mirembajtje Sistemeve Ngrohje - Ftohje , Instalime dhe Mirembajtje Kondisioneresh – **1 person**
- Instruktor/e Marketing Digjital - **1 person**
- Instruktor/e Berber - **3 persona**
- Instruktor/e Manikyr- Pedikyr - **1 person**
- Instruktor/e Ndhimes ne Masazheri - **1 person**
- Instruktor/e Sisteme te thata ne ndertesa - **1 person**
- Instruktor/e Sekretari - **1 person**
- Instruktor/e Prodhime Brumi , Pasteri , Picajol- **1 person**
- Instruktor/e Kujdestari Femijesh - **2 persona**
- Instruktor/e Kujdestari per te moshuar, Kujdestari per persona me aftesi te kufizuara ,Kujdestar Social - **1 person**
- Instruktor/e Riparues Kompjuteri - **1 person**
- Instruktor/e Gjuhe e Huaj Gjermanisht - **1 person**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplome nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në profesionin e kursit të formimit profesional për të cilin po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën ,në të cilën është kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shendetesore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre.

Dokumentet ne gjuhen e huaj duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin te ofrusit publik të AFP-së brenda dates 04.03.2024

DREJTOR

Krenar XHEMALI

